

## PJESA B

### LENDE VEPRUESE ME NATYRE BIOLOGJIKE ( Shih versionin e plote anglisht)

#### I. TE DHENA MBI ORGANIZMIN VEPRUES

##### 1. Identiteti i organizmit veprues.

- 1.1. Aplikuesi dhe Mbajtesi i Dokumentit te Regjistrimit (Emri, Adresa, etj.).
- 1.2. Prodhuesi (emri, adresa, etj, perfshire vendndodhjen e impianteve te prodhimit).
- 1.3. Emri i zakonshem.
- 1.4. Emri taksonomik dhe raca per bakteriet, protozoaret dhe kerpudhat, sqarime nese eshte variant i zakonshem ose mutant; nese eshte e mundur pershkrimi i emertimit taksonomik te agjentit, stereotipi, raca ose mutanti.
- 1.5. Numri referues i koleksionit dhe kultures ku eshte depozituar.
- 1.6. Procedurat e pershtatshme per testimin dhe kriteret qe perdoren per identifikimin (p.sh. morfologjike, biokimike, serologjike).
- 1.7. Perberja - pastertia mikrobiologjike, natyra, identiteti, vetite, permbajtja e papastertive dhe organizmave te huaja.

##### 2. Vetite biologjike te organizmit veprues

- 2.1. Organizmat qe luftohen. Patogjeniciteti ose lloji i antagonizmit me strehuesin, doza infektive, transmetimi dhe informacion per menyren e veprimit.
- 2.2. Historia e organizmit dhe perdorimit te tij. Çfaqja natyrale dhe perhapja gjeografike.
- 2.3. Kufiri specifik i strehuesve dhe efektet ne organizmat e tjera qe nuk jane objekt i luftimit duke perfshire speciet qe jane me te peraferta me ato qe luftohen - te perfshihet infektiviteti, patogjeniciteti dhe transmetuesmeria.
- 2.4. Infektiviteti dhe qendrueshmeria fizike kur perdoret sipas metodes se rekomanduar. Efekti i temperatures, ekspozimit ndaj rrezatimit diellor, etj. Qendrueshmeria ne kushtet mjedisore te mundshme per perdorim.
- 2.5. Nese organizmi eshte i lidhur ngushte me patogjenet bimore, patogjenet e specieve vertebrorore ose specie jovertebrorore qe nuk jane objekt luftimi.
- 2.6. Provat laboratorike te stabilitetit gjenetik (p.sh. shkalla e mutacioneve) ne kushtet mjedisore ku propozohet te perdoret.
- 2.7. Prezenca, mungesa ose prodhimi i toksinave natyra, identiteti, struktura kimike dhe qendrueshmeria e tyre.

##### 3. Informacion tjeter per organizmin veprues

- 3.1. Funksioni, p.sh. fungicid, herbicid, insekticid, largues, rregullator rritje.
- 3.2. Menyra e veprimit, p.sh. veprim kontakti, frymemarrje ose te brendshem (stomaku), fungitoksik ose fungistatik, etj., sistemik ose jo sistemik ne bime.
- 3.3. Fusha e perdorimit, p.sh. ambiente te jashtme, ambiente te brendeshme, ushqimet ose bazen ushqimore ne ruajtje, kopshte shtepiake.
- 3.4. Ku eshte e nevojshme, simbas rezultatit te provave, kushtet specifike agroteknike, te shendetit te bimeve dhe/ose kushtet mjedisore ne te cilat pesticidi mund te perdoret ose te mos perdoret.
- 3.5. Organizmat demtues qe lufton dhe bimet ose produktet bimore qe mbron.

3.6. Metoda e prodhimit me pershkrimin e teknikave te perdorura per sigurimin e prodhimit uniform dhe metodat e analizave per standartizimin e tij. Ne rastin e mutanteve, te jepet informacion i detajuar per paraqitjen dhe izolimin se bashku me te gjitha diferencat e njohura midis mutantit dhe races se eger prinderore.

3.7. Metodatat per evitimin e humbjes se virulences ne racen prinderore.

3.8. Metodatat e rekomanduara dhe kujdesi ne lidhje me mbajtjen, magazinimin, transportin dhe ruajtjen nga zjarri.

3.9. Mundesia qe organizmi veprues te behet i pa efektshem.

#### **4. Metodatat analitike**

4.1. Metodatat per ruajtjen e identitetit dhe pastertise se materialit baze nga i cili jane prodhuar partite dhe rezultatet e arritura, perfshire informacionin per ndryshueshmerine.

4.2. Metodatat per te pare pastertine mikrobiologjike te produktit perfundimtar dhe per te treguar ndotesit jane kontrolluar deri ne nje nivel te pranueshem, rezultatet e arritura dhe informacion per ndryshueshmerine.

4.3. Metodatat e perdorura per te treguar qe nuk ka patogjene te njerezve ose gjitareve te tjere si ndotes ne agjentin aktiv, perfshire ne rastin e protozoareve dhe kerpudhave efektet e temperatures (35°C dhe temperatura te tjera perkatese).

4.4. Metodatat per percaktimin e mbetjeve te gjalla ose jo te gjalla (p.sh. toksina) ne ose mbi produktet e trajtuara, ushqimet per njerezit dhe blegtorine, lengjet dhe indet e njerezve dhe kafsheve, toke uje, ajer.

#### **5. Studimet per toksikologjine, patogjenicitetin dhe infektivitetin**

##### **5.1. Bakteriet, kerpudhat, protozoaret dhe mykoplazmat**

5.1.1. Toksiciteti dhe/ose patogjeniciteti dhe infektiviteti

5.1.1.1. Per nje doze te vetme nga goja

5.1.1.2. Ne rastet kur nje doze e vetme nuk eshte e pershtatshme per vleresimin e patogjenicitetit, duhet te kryhen nje seri testesh per zbulimin agjentet me toksicitet dhe infektivitet te larte.

5.1.1.3. Per nje doze te vetme nga lekura.

5.1.1.4. Per nje doze te vetme nga organet e frymemarrjes.

5.1.1.5. Per nje doze te vetme me injektim nen lekure.

5.1.1.6. Irritimi i lekures dhe syve.

5.1.1.7. Ndjeshmeria e lekures.

5.1.2. Toksiciteti afatshkurter (ekspozim 90-ditesh)

5.1.2.1. Per marrjen nga goja.

5.1.2.2. Nepermjet rrugeve te tjera (me frymemarrje, nga lekura).

5.1.3. Studime plotesuese per toksicitetin dhe /ose patogjenicitetin dhe efektivitetin.

5.1.3.1. Toksiciteti afatgjate nga goja dhe kancerogjeniciteti.

5.1.3.2. Mutagjeniciteti.

5.1.3.3. Studimet per teratogjenicitetin.

5.1.3.4. Studim per shume brezni tek gjitaret (te pakten 2 brezni).

5.1.3.5. Studime per metabolizmin - absorbimi, shperndarja dhe nxjerrja jashte organizmit tek gjitaret, perfshire sqarimin e rrugeve metabolike.

5.1.3.6. Studime per neurotoksicitetin, perfshire prova per neurotoksicitetin tek pulat e rritura.

5.1.3.7. Immunotoksiciteti, p.sh. veprimi alergjik.

5.1.3.8. Patogjeniciteti dhe infektiviteti si rezultat i dobësimit të imunitetit.

## **5.2. Viruset, viroidet**

5.2.1. Toksiciteti akut dhe/ose patogjeniciteti dhe infektiviteti. Te dhena siç nenvizohen në piken 5.1.1. dhe prova biologjike të kryera në kultura të pershtatshme qelizore duke përdorur virus infektiv të paster dhe kultura primare qelizore gjitharesh, zogjsh dhe peshqish.

5.2.2. Toksiciteti afatshkurter. Te dhena siç nenvizohen në piken 5.1.2. dhe prova për infektivitetin të kryera në organizma ose në kultura të pershtatshme qelizore të pakten 7 dite pas ditësh nga dhënia e fundit tek kafshet në prove.

5.2.3. Studime plotësuese toksikologjike dhe/ose për patogjenicitetin dhe infektivitetin siç nenvizohen në piken 5.1.3.

5.3. Efektet helmuese në blegtori dhe kafshet shtëpiake.

5.4. Te dhena mjekësore

5.4.1. Kujdesi mjekësor për personelin që punon në impiantet prodhuese.

5.4.2. Te dhena në lidhje me ndikimin në shendet, nga industria dhe bujqësia.

5.4.3. Vezhgime për ekspozimin e popullatës në përgjithësi dhe te dhena epidemiologjike.

5.4.4. Diagnoza e helmimit, shenjat specifike të helmimit, provat klinike nëse është e mundur.

5.4.5. Ndjeshmeria/alergjiciteti nëse është e pershtatshme.

5.4.6. Trajtimi i propozuar, masat për ndihmën e parë, antidotet, trajtimi mjekësor nëse është e pershtatshme.

5.4.7. Parashikimi i efekteve të pritshme të helmimit nëse është e pershtatshme.

5.5. Përmbledhje e toksicitetit për gjitarët dhe konkluzionet (përfshirë NOAEL, NOEL dhe ADI, nëse është e pershtatshme)

## **6. Mbetjet në ose mbi produktet e trajtuara, ushqimet e njerezve dhe kafsheve.**

6.1. Identifikimi i mbetjeve të gjalla ose jo të gjalla (p.sh. toksinave) në produktet e trajtuara; mbetjet e gjalla me vlerësim në kulture ose organizem kurse mbetjet jo të gjalla me teknika të tershtatshme.

6.2. Mundësia e shumëfishimit të agjentit aktiv në ose mbi ushqime se bashku me ndonjë raport mbi efektin në cilësinë e ushqimit.

## **7. Fati dhe sjellja në mjedis**

7.1. Shpërndarja, levizja, shumëfishimi dhe qëndrueshmëria në ajër, ujë dhe tokë.

7.2. Informacion mbi fatin e mundshëm dhe zinxhirin ushqimor.

## **8. Studime ekotoksikologjike**

8.1. Zogjte - toksiciteti akut oral dhe/ose patogjeniciteti dhe infektiviteti.

8.2. Peshqit - toksiciteti akut dhe/ose patogjeniciteti dhe infektiviteti.

8.3. Toksiciteti për *Daphnia magna*.

8.4. Efektet në rritjen e algave.

8.5. Toksiciteti akut dhe/ose patogjeniciteti dhe infektiviteti për parazitët dhe predatorët kryesore të specieve që janë objekt luftimi.

8.6. Bletët - toksiciteti akut dhe/ose patogjeniciteti dhe infektiviteti.

8.7. Krimbat e tokës - toksiciteti akut dhe/ose patogjeniciteti dhe infektiviteti.

8.8. Shtrirja e ndotjes indirekte ne bimet fqinje qe s'jane objekt trajtimi, bimet e egra, toke dhe uje.

8.9. Efektet ne floren dhe faunen tjeter.

## **10. Propozime per masat parambrojtese**

Frazat e rrezikut dhe sigurise.

## **10. Fleta me te dhenat per sigurine (Safety Data Sheet) e agjentit aktiv.**

# **II. TE DHENA PER PMB-ne**

## **1. Identiteti i PMB-se**

1.1. Aplikuesi (Emri, Adresa, etj.)

1.2. Prodhuesi i produktit dhe i agjentit/agjenteve aktive, emri, adresa, etj, perfshire vendndodhjen e impianteve te prodhimit.

1.3. Emri tregetar ose emri tregetar i propozuar dhe kodi i prodhuesit per produktin (nese ka).

1.4. Informacion i detajuar per perberjen sasiore dhe cilesore te produktit (organizmi/organizmat aktive, perberesit inerte, organizmat e jashtme, etj.)

1.5. Gjendja fizike dhe natyra e produktit (koncentrat i emulsionueshem, pluhur i lagshem, etj.)

1.6. Kategoria e perdorimit (insekticid, fungicid, etj.)

## **2. Vetite teknike te produktit**

2.1. Aparenca (ngjyra dhe era)

2.2. Stabiliteti ne ruajtje dhe periudha e ruajtjes. Efekti i temperatures, menyres se paketimit dhe ruajtjes ne efektivitetin biologjik.

2.3. Metodat per krijimin e stabilitetit per magazinim dhe periudhen e ruajtjes.

2.4. Karakteristikat teknike te formulimit

2.4.1. Lagshmeria

2.4.2. Qendrueshmeria e shkumes.

2.4.3. Suspensibiliteti dhe qendrueshmeria e suspensionit.

2.4.4. Testi i sitjes se lagur dhe sitjes se thate.

2.4.5. Shperndarja e madhesise se grimcave, permbajtja e pluhurit te cilesise se larte, grimcimi dhe shkrifmeria.

2.4.6. Ne rastin e granulave; testi i sitjes dhe treguesi i shperndarjes se peshes se granulave, te pakten per fraksionin me madhesi grimcash me te madhe se 1 mm.

2.4.7. Permbajtja e agjentit aktiv ne ose mbi grimcat e ushqimit te helmuar, granula ose faren e trajtuar.

2.4.8. Emulsionimi, riemulsionimi dhe qendrueshmeria e emulsionit.

2.4.9. Rrjedhshmeria, derdhshmeria dhe pluhurizimi.

2.5. Pajtueshmeria fizike dhe kimike me produkte te tjera, perfshire pesticidet me te cilat perdorimi i tij do te autorizohet.

2.6. Lagia, ngjitja dhe perhapja ne bimet qe trajtohen.

### **3. Te dhena per perdorimin**

3.1. Fusha e perdorimit, p.sh. ambiente te jashtme, ambiente te brendeshme, ushqimet ose bazen ushqimore ne ruajtje, kopshte shtepiake.

3.2. Hollesira per perdorimin e parashikuar p.sh. organizmat demtues qe lufton dhe/ose bimet ose produktet bimore qe mbron.

3.3. Ku eshte e nevojshme, simbas rezultatit te provave, kushtet specifike agroteknike, te shendetit te bimeve dhe/ose kushtet mjedisore ne te cilat pesticidi mund te perdoret ose te mos perdoret.

3.4. Doza e rekomanduar e perdorimit.

3.5. Perqendrimi i agentit aktiv ne materialin e perdorur (p.sh. % ne solucionin sperkates).

3.6. Menyra e perdorimit.

3.7. Numri i trajtimeve, koha e perdorimit dhe kohezgjatje e efektit mbrojtës.

3.8. Fitopatogjeniciteti.

3.9. Instruktimet e propozuara per perdorimin.

### **4. Informacion plotesues per PMB-ne**

4.1. Ambalazhimi (tipi, materialet, madhesia, etj.)

4.2. Periudha e rihyrjes ne ambientin e trajtuar, periudha e nevojshme e pritjes (karenca) ose masa te tjera paraprake per mbrojtjen e njerezve dhe kafsheve.

4.3. Metodrat e rekomanduara dhe kushtet paraprake ne lidhje me mbajtjen, magazinimin, transportin dhe mbrojtjen nga zjarri.

4.4. Masat emergjente ne rast aksidenti.

4.5. Procedura e asgjесimit te produktit te panevojshem dhe ambalazhit te tij.

### **5. Metodrat analitike**

5.1. Metodrat analitike per percaktimin e perberjes se produktit.

5.2. Metodrat per percaktimin e mbetjeve ne ose mbi bimet e trajtuara dhe produktet bimore (p.sh. provat biologjike).

5.3. Metodrat qe perdoren per te pare pastertine mikrobiologjike te produktit.

5.4. Metodrat qe perdoren per te pare qe produkti nuk ka ndonje patogjen per njerezit ose kafshet gjitare dhe, nese nevojitet, per bletet.

5.5. Teknikat qe perdoren per te siguruar uniformitetin e produktit dhe provat per standartizimin e tij.

### **6. Te dhena per efikasitetin**

6.1. Testet paraprake per percaktimin e dozave.

6.2. Eksperimentet fushore.

6.3. Informacion mbi mundesine e çfaqjes dhe zhvillimit te rezistences.

6.4. Efekti ne cilesine dhe rendimentin e bimeve te trajtuara.

6.5. Fitotoksiciteti per bimet qe do trajtohen (perfshire kultivaret e ndryshem)

6.6. Vrojtime per efektet anesore te padeshiruara dhe te papritura p.sh. per organizmat e dobishem dhe ata qe nuk jane objekt i luftimit, per bimet pasardhese, bimet e tjera ose pjese te bimeve te trajtuara qe perdoren per qellime shumezimi (p.sh. fara, kalema, etj).

### **7. Studimet per toksicitetin dhe/ose patogjenicitetin dhe infektivitetin**

- 7.1. oral me nje doze
- 7.2. nga lekura me nje doze
- 7.3. me frymemarrje
- 7.4. iritimi i lekures dhe syve
- 7.5. ndjeshmeria e lekures
- 7.6. Te dhenat toksikologjike ne dispozicion per substancat jo aktive
- 7.7. Ekspozimi i punetoreve
- 7.8. Absorbimi nga lekura
- 7.9. Mundesia e ekspozimit te punetoreve ne kushtet fushore, duke perfshire analizat sasiore per ekspozimin e tyre.

## **8. Mbetjet ne ose mbi produktet e trajtuara, ushqimet dhe ushqimet per blegtorine**

8.1. Te dhena per mbetjet ne lidhje me agjentin aktiv nga provat e kryera ne bime dhe produkte ushqimore per te cilat kerkohet autorizimi. Eshte gjithashtu e nevojshme te identifikohen organizmat e gjalla dhe jo te gjalla ne bimet e trajtuara.

8.2. Efektet e perpunimit industrial dhe/ose pergatitjes ne kushte shtepiace mbi natyren dhe rendesine e mbetjeve.

8.3. Efektet e mbetjeve per prishjen, eren, shijen dhe aspekte te tjera cilesore te produkteve te fresketa ose te perpunuara.

8.4. Vleresimi i mbetjeve ne produktet me origjine shtazore si rezultat i ushqimeve ose shtreses se trajtuar.

8.5. Te dhena per mbetjet ne kulturat pasardhese kur mund te pritet prezenca e tyre.

8.6. Periudha e propozuar e pritjes (karenca) per perdorimet e parashikuara, ose periudha e ruajtjes ose magazinimit per perdorimin pas vjeljes.

8.7. Nivelet maksimale te mbetjeve te propozuara (MRLs) dhe justifikimi per pranimin e ketyre niveleve (per toksinat).

## **9. Studimet ekotoksikologjike**

9.1. Efektet tek organizmat ujore

9.1.1. Peshqit

9.1.2. Studimet per Daphnia magna

9.1.3. Studimet per mikroorganizmat ujore

9.2. Efektet ne organizmat dobishme dhe organizmat e tjera qe nuk jane objekt i luftimit

9.2.1. Efektet tek bleta

9.2.2. Efektet tek organizmat e tjere te dobishem

9.2.3. Efektet tek krimbat e tokes

9.2.4. Efektet tek fauna tjetere e tokes

9.2.5. Efektet ne mikrofloren e tokes.

## **10. Informacion plotesues**

10.1. Informacion per autorizimet ne vende te tjera.

10.2. Informacion per nivelet maksimale te mbetjeve te vendosura ne vende te tjera.

10.3. Propozime perfshire dhe justifikimet per klasifikimin e produktit ne baze te toksicitetit te tij si dhe simbolet e rrezikut, treguesit e rrezikut, frazat e rrezikut dhe sigurise qe duhet te vihen ne etikete.

10.4. Mostra te ambalazhit te propozuar.

## **11. Fleta me te dhenat per sigurine (safety data sheet) e PMB-se**

**2. PER REGJISTRIMIN E NJE PMB-je, QE PERMBAN TE NJEJTEN LENDE VEPRUESE  
ME NJE PMB TE REGJISTRUAR ME PARE NGA E NJEJTA KOMPANI, POR NE  
FORMULIM TJETER.**

1. Identiteti i PMB-se.
2. Vetite fizike, kimike dhe teknike te PMB-se.
3. Te dhena per perdorimin
4. Informacion i mëtejshëm mbi PMB-ne.
5. Te dhena per efikasitetin.
6. Studime toksikologjike.
7. Mbetjet në ose mbi produktet e trajtuara, ushqimin e njërëzve dhe të kafshëve.
8. Rreziku dhe veprimi mjedisor.
9. Studime ekotoksikologjike.
10. Informacion plotesues.
11. Fleta me te dhenat per sigurine (safety data sheet) te PMB-se.

**Shenim:** Te dhenat e mesiperme do te zberthehen ne hollesi, siç jane trajtuar per PMB-ne.

### 3. PER REGJISTRIMIN E NJE PMB-je ME NATYRE INORGANIKE.

1. Identiteti i PMB-se.
2. Vetite fizike, kimike dhe teknike te PMB-se.
3. Te dhena per perdorimin
4. Informacion plotesues per PMB-ne.
5. Metodot analitike.
6. Te dhena per efikasitetin.
7. Studimet per toksicitetin e PMB-se.
8. Mbetjet ne ose mbi produktet e trajtuara, ushqimet dhe ushqimet per blegtorine ku propozohet te perdoret.
9. Fati dhe sjellja ne mjedis.
10. Fleta me te dhenat per sigurine (safety data sheet) te PMB-se.

**Shenim:** Te dhenat e mesiperme do te zberthehen ne hollesi, siç jane trajtuar per PMB- ne.

#### 4. PER REGJISTRIMIN E NJE PMB-je IDENTIKE.

1. Nje dosje me te dhena, te cilat plotesojne kushtet per t'u quajtur identik,
2. Nje deklarate se PMB-ja, e cila kerkohej te regjistrohet, eshte identike me nje PMB te regjistruar me pare,
3. Emrin tregtar te PMB-se te importuar,
4. Numrin e autorizimit te PMB-se te importuar,
5. Emrin tregtar te PMB-se te referencës,
6. Numrin e autorizimit te PMB-se te referencës,
7. Emrin tregtar, me te cilin PMB-ja do te tregtohet ne vend,
8. Etiketen e propozuar origjinale, te PMB-se te importuar dhe perkthimin zyrtar te saj ne gjuhën shqipe,
9. Propozimin per etiketën, qe do te perdoret per tregtimin e PMB-se ne vend,
10. Nje kampion te PMB-se, siç do te tregtohet ne vend,
11. Nje kampion te ambalazhit, siç do te tregtohet ne vend, dhe
12. Çdo informacion tjetër suplementar, qe gjykohej i nevojshëm per te percaktuar nese jane respektuar kerkesat specifike te ketij vendimi.

**Shenim:** Te dhenat e mesiperme do te zberthehen ne hollesi, siç jane trajtuar per PMB- ne.

**5. PER REGJISTRIMIN E NJE PMB-je, LENDA VEPRUESE E TE CILES PERMBAHET NE NJE PMB TE REGJISTRUAR NDERSA, LENDET JO VEPRUESE JANE TE NDRYSHME.**

1. Te dhena fiziko - kimike per lendet jo vepruese
2. Ne se gjykohet e nevojshme nga SPMB-ja, aplikanti duhet te paraqese te dhena per fitotoksicitetin dhe toksicitetin akut.

**6. PER PMB-te E REGJISTRUARA, KUR NGA MBAJTESI I CERTIFIKATES SE REGJISTRIMIT KERKOHET ZGJERIMI I FUSHES SE PERDORIMIT (Ndryshime ne Etikete).**

1. Kerkesa.
2. Emri tregtar i PMB-se.
3. Numri dhe data e regjistrimit.
4. Bimet dhe organizmat, ku kerkohet te zgjerohet veprimi.
5. Doza e propozuar e perdorimit.
6. Periudha e pritshmerise (karenca).
7. Niveli maksimal i mbetjeve(MRL).
8. Informacion mbi regjistrimet ne vende te tjera ne lidhje me zgjerimin e propozuar te perdorimit.

**Shenim:** Te dhenat e mesiperme do te zberthehen ne hollesi, siç jane trajtuar per PMB- ne.

## **7. PER PMB - te E PRODHUARA DHE REGJISTRUARA NGA KOMPANI TE HUAJA, POR QE KERKOHET TE PRODHOHEN NE SHQIPERI.**

1. Deklarate e prodhuesit te huaj, e mbajtesit te dokumentit te regjistrimit dhe e prodhuesit vendas, ne te cilen pranohet se PMB-ja e prodhuar ne Shqiperi do te kete te njejtet tregues me ato te deklaruar ne dosjen e regjistrimit.

## **8. PER RIREGJISTRIMIN E NJE PMB-je, TE CILES I PERFUNDON AFATI I REGJISTRIMIT.**

### **1. Identiteti i PMB-se.**

- 1.1. Aplikuesi (Emri, Adresa, etj.).
- 1.2. Emri i PMB-se.
- 1.3. Numri referues i regjistrimit.
- 1.4. Deklarata mbi identitetin.

### **2. Nese ka ndryshime, ato duhet te deklarohen, se bashku me ndikimet, qe keto ndryshime japin ne:**

- 2.1. vetite fizike e kimike
- 2.2. vetite toksikologjike, ekotoksikologjike, mjedisore, ne perdorim, etj.

### **3. Te dhena per regjistrimet ne vende te tjera**

- 3.4. Informacion mbi perfshirjen e lendes vepruese ne shtojcen II, bashkelidhur ketij vendimi.

**Shenim:** Te dhenat e mesiperme do te zberthehen ne hollesi, siç jane trajtuar per PMB- ne.